

VENDIM
Nr. 472, datë 17.7.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 612, DATË 5.9.2012,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT
‘PËR AKCIZAT’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 54, pika 5, 108 e 109, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit ‘Për akcizat’”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 50/1 ndryshon në titull dhe në përmbajtje, si më poshtë vijon:

“Neni 50/1

Statusi i personave të autorizuar për veprimtarinë e pullave fiskale

Për qëllime të neneve 40–43, të seksionit 8, të kreut V, të ligjit, personi juridik publik i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale duhet të marrë statusin e depozituesit të miratuar prodhues.”.

Neni 2

Pika 2, e nenit 102, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. “Shënjes” është një substancë apo element, prezenca e së cilës/të cilit, në përgjithësi, nuk është e dukshme, por zbulohet me anë të reaksionit kimik, biologjik ose të proceseve teknologjike.”.

Neni 3

Pas nenit 102 shtohet neni 102/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 102/1

Procedurat për ngjyrimin/shënjimin për nënproduktet e naftës me përjashtim apo reduktim nga akciza

Nënproduktet, të cilat përfitojnë përjashtim apo reduktim nga pagesa e akcizës ngjyrosen dhe/ose shënjohen sipas procedurës së përcaktuar në nenet 103–109, të këtij vendimi.”.

Neni 4

Pas nenit 109 shtohen nenet 109/1 dhe 109/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 109/1

Shënjimi/ngjyrimi i produkteve energjetike, që i nënshtrohen pagesës së akcizës

1. Për qëllim të ushtrimit të kontrollit nga administrata doganore, produktet, të cilat kanë detyrim pagimin e akcizës, mund të shënjojnë/të ngjyrosen. Produktet e shënjitimit janë produktet e bardha (gazoil dhe benzen), produktet e zeza (solar dhe mazut), lëndët djegëse dhe produktet e ndërmjetme, specifikisht produktet me emërtimet dhe klasifikimin tarifor të NKM,-së si vijon: gazoil (27101943, 27101946 dhe 29101948), benzinë pa plumb (27101241, 27101245 dhe 27101249), solar/mazut (27101962, 27101964, 27101968). Administrata doganore është përgjegjëse për administrimin e procesit të shënjitimit/ngjyritimit.

2. Substancat, që përdoren si shënjes/ngjyres për qëllime kontrolli, njihen si të përshtatshme nga një komision i posaçëm, ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, përpara përdorimit të tyre për herë të parë në territorin kombëtar. Këto substanca importohen vetëm nga administrata doganore.

3. Procesi i shënjitimit/ngjyritimit realizohet përpara kryerjes së pagesës së akcizës dhe shoqërohet me një dokument, që vërteton kryerjen e shënjitimit/ngjyrosjes.

4. Mbikëqyrja dhe kontrolli është procesi që kryhet nga administrata doganore me anë të teknologjisë së posaçme në dispozicion të saj, nëse këto produkte janë shënjuar/ngjyrosur.

5. Asnjë nga produktet e akcizës, për të cilat është i detyrueshëm shënjitimi/ngjyritimi, nuk mund të hidhet për konsum/qarkullim të lirë i pashënjuar/i pangjyrosur.

Neni 109/2

Porositja dhe kryerja e shërbimit të shënjitimit/ngjyritimit

1. Procesi i shënjitimit/ngjyritimit kërkohet nga subjektet dhe realizohet përpara kryerjes së pagesës së detyrimeve të akcizës për produktet e shënjitimit/ngjyritimit në zotërim të subjekteve të detyruara.

2. Kërkesa duhet të specifikojë:

- a) identitetin e subjektit, që kërkon kryerjen e shërbimit të shënjitimit;
- b) veprimtarinë tregtare të zhvilluar nga subjekti zotërues i produktit të shënjitimit;
- c) llojin e produktit;
- ç) vëllimin e produktit;
- d) vendndodhjen e produktit dhe mënyrën e ruajtjes së tij.

3. Kërkesat e marra regjistrohen në regjistrin e posaçëm të porosive. Në përfundim të shënjitimit/ngjyritimit, subjekti pajiset me dokumentin përkatës, që vërteton kryerjen e shënjitimit/ngjyritimit.

4. Procedura më të hollësishme për administrimin e procesit të shënjitimit/ngjyritimit, si dhe mbikëqyrjen e kontrollin e tij përcaktohen me udhëzim të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, i cili publikohet në Fletoren Zyrtare.”.

Neni 5

Vendimi nr. 498, datë 30.5.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e shënjitimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 6

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 9.8.2024.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku